



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 426/17 prot.

Tiranë, më 23.12.2019

**VENDIM**  
**Nr.197, datë 23.12.2019**

**PËR**  
**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT**  
**TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 52, DATË 30.05.2019, NË**  
**INSTITUCIONIN DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË**  
**INDUSTRIALE**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraparak të Drejtorit të Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 52, datë 30.05.2019, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”,

**KONSTATOVA SE:**

Me vendimin nr. 27, datë 19.04.2019, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale.

Pas përfundimit të mbikëqyrjes, Komisioneri ka dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, raportin përfundimtar dhe vendimin paralajmërues për

rregullimin e ligjshmërisë me nr. 52, datë 30.05.2019, duke i lënë institucionit detyra për përmirësimin e situatës, si dhe një afat prej 30 ditësh për zbatimin e tyre.

Mbështetur në gjetjet e specifikuar në këtë raport, si dhe në detyrat e lëna për institucionin e mbikëqyrur, në përmbajtjen e vendimit paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë, si dhe duke verifikuar materialin shkresor të dërguar nga institucioni, konstatoj se, situata aktuale e administrimit të shërbimit civil, e specifikuar sipas radhës së detyrave në vendim, rezulton si më poshtë:

Në vendimin paralajmërues të Komisionerit, konkretisht në pikën 2 të tij, është lënë detyrë, për njësinë përgjegjëse, DAP, unifikimin e kategorizimin e pozicioneve të punës në shërbimin civil, në institucionet e varësisë, *(në rastin konkret për pozicionet e punës “Drejtor Drejtorie” dhe “Përgjegjës Sektori”)* në përputhje me kërkesat e nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Konstatoj se, institucioni i mbikëqyrur me shkresën nr. 291 prot., datë 01.07.2019, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 426/13 prot., datë 02.07.2019, i është drejtuar Departamentit të Administratës Publike, në rolin e njësisë përgjegjëse, për të marrë mendim në lidhje me unifikimin e kategorizimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil, konkretisht për pozicionet “Drejtor Drejtorie” dhe “Përgjegjës Sektori”.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Departamenti i Administratës Publike me shkresën nr.3965/1 prot., datë 10.07.2019, e protokolluar pranë Komisionerit me nr. 426/15 prot., datë 12.07.2019, ka sqaruar se, në kuadër të projektit IPA 2014, “Zbatimi i reformës së shërbimit civil në administratën publike”, DAP në bashkëpunim me grupin e ekspertëve të projektit, prej muajit tetor 2018, ka filluar punën për zbatimin e këtij projekti, ku dy ndër aktivitetet kryesore të tij, lidhen me, zhvillimin e sistemit të ri të pagave të nëpunësve civilë dhe reformimin e sistemit të pagave të administratës publike në tërësi, si dhe rishikimin e metodologjisë së klasifikimit të pozicioneve të punës dhe përshkrimeve të punës, hartimin e një katalogu të pozicioneve të punës, etj.

Në pikat 3 dhe 4, të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka lënë detyrë për institucionin e mbikëqyrur, të përmbyllë procesin e vlerësimit të rezultateve në punë për Drejtorin e Përgjithshëm të institucionit, i cili është anëtar i TND-së.

Vërej se, nga ana e institucionit Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale janë marrë të gjitha hapat për zbatimin e kësaj detyre, konkretisht me shkresën nr. 229/3 prot., datë 01.07.2019, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 426/14 prot., datë 03.07.2019, ky institucion ka bërë me dije Komisionerin se, vlerësimi i punës së Drejtorit të Përgjithshëm, anëtar i TND-së i është dërguar Sekretarit të Përgjithshëm, në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 259 prot., datë 14.06.2019.

Në pikën 5 të vendimit paralajmërues është lënë detyrë, për njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, sistemimi i dosjeve të personelit, duke i organizuar dhe plotësuar sipas përcaktimeve të lidhjeve 1 e 2, pjesë e Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, duke bërë pjesë të saj të gjithë dokumentacionin që është konstatuar si mangësi në raportin përfundimtar.

Nga praktika shkresore, rezulton se, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, në zbatim të detyrës së lënë në vendimin paralajmërues të Komisionerit ka plotësuar dosjet e personelit të çdo nëpunësi sipas lidhjeve nr. 1 dhe 2, pjesë e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 117, datë 05.03.2014. Aktualisht, dosjet e personelit janë në gjendje të mirë dhe administrohen nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore në institucion.

Duke vlerësuar punën e njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore në këtë institucion, si dhe nga gjithë sa u analizua më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të administruar gjatë procesit të verifikimit, arrij në konkluzionin se nga ana e institucionit janë zbatuar drejt detyrimet e lëna në vendimin paralajmërues të Komisionerit dhe janë realizuar plotësisht ato.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 52, datë 30.05.2019, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit paralajmërues të Komisionerit Nr. 52, datë 30.05.2019.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si dhe Departamenti i Administratës Publike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**